

ABSTRACT

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut janë themelët e vlerave dhe identitetit evropian. Unioni Evropian (më tutje referuar edhe si UE) është bashkësi shtetesh, me vlera dhe synime të përbashkëta. Si i tillë, i njëjti ka përgjegjësi ndaj anëtarëve të kësaj bashkësie për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Karta e Lirive Themelore dhe Gjykata e Drejtësisë e UE (me tutje referuar edhe si GJED) janë instrumente kyçë në këtë kontekst. UE i njeh të drejtat dhe liritë e parashikuara me Kartën e të Drejtave Themelore e po ashtu e Drejta e UE është e përbërë nga parimet e përgjithshme të parapara nga kjo Kartë. Gjykata E Drejtësisë e UE përbën institucionin i cili së bashku me shtetet anëtare interpreton dhe zbaton ligjet e UE që nga vitin 1952. Që nga viti 2009 mbrojtja e të drejtave të njeriut në UE është fuqizuar dukshëm dhe kjo është rezultat i fuqisë detyruese të Kartës së Lirive Themelore dhe rolit aktiv të GJED-së. Rritja e rolit dhe autoritetit të këtyre dy institacioneve ka ndikuar pozitivisht në garantimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të qytetarëve në UE, ndërkohë ka sfiduar shtetet anëtare për të përshtatur praktikat e tyre ligjore dhe politikat me standardet e larta evropiane për të drejtat e njeriut.

Studimi im ka për qëllim ofrimin e një analize thelbësore të përpjekjeve të UE për të siguruar mbrojtjen të duhur të drejtave themelore brenda territorit të tij. Do të analizohen Korniza Ligjore dhe institucionale e Kartës dhe Gjykatës së Drejtësisë së UE, në mënyrë që të identifikohet kontribuimi i tyre në forcimin e standardeve të të drejtave të njeriut.

Fjalët kyçë: *Gjykata, të drejtat, drejtësia, GJED, UE etj.*